

Selver ISLAMAJ

Tradita e tregimit mbi viktimën shekullore dhe rezistencës flijuese deri në kulmimin me komandantin legjendar dhe flijimin e familjes Jashari

Tradita mbi tregimin e viktimizimit të popullsisë shqiptare të Kosovës

Për shkak të rrethanave historike, shqiptarët e Kosovës kanë kultivuar traditën e tregimit mbi sakrificën e përjetshme për breza, e cila përmes rrethanave dhe ngjarjeve të përsëritura ka mbijetuar. Fillimet mund të gjenden në fund të shekullit të XIX, dhe që nga ajo kohë mbaheshin gjallë në traditën e odës. Rrëfimet datojnë që nga gjysma e parë e shekullit XIX dhe kanë të bëjnë me myslimanët shqipfolës që jetonin në Serbinë autonome, të cilët u detyruan të emigrojnë nga ai vend. Botimet moderne shpeshherë i referohen botimeve serbe nga ajo periudhë.

“Nga burimet serbe mund të shihet se në Valevë në vitin 1788 jetonin qindra familje myslimane (shqiptarë, turq dhe myslimanë) dhe në vitin 1826 kishin mbetur vetëm 30 familje. Në Qupri në vitin 1826 ishin 230 familje shqipfolëse, nga të cilat në vitin 1834 nuk kishte mbetur asnjë. Në Beograd në vitin 1818 kishte rreth 2.500 familje shqipfolëse dhe në vitin 1826 nuk u regjistrua asnjë. Në Uzhicë të vitit

1818 ishin rreth 1.000 familje shqipfolëse dhe 1838 nuk ishte më asnjë në listë e regjistrit."¹

Historianët i referohen dëbimeve të popullsisë shqipfolëse që nga viti 1837, të cilat kanë ndodhur në një shkallë të madhe dhe përpiqen t'i vërtetojnë këto ngjarje me anë të burimeve serbe.

*"Pason Narçetania nga Ilija Garašanin nga 1844 dhe dëbimi i familjeve shqiptare nga 630 fshatra. Sipas burimeve serbe, në mesin e shekullit të XIX, në afërsi të Leskovcit dhe Prokuplit kishte rreth 300 vendbanime shqipfolëse."*²

Pas Kongresit të Berlinit më 1878, Serbisë iu dha zona ndërmjet Nishit dhe Vranjës, e cila në atë kohë ishte e banuar kryesisht nga shqiptarët dhe muslimanët. Ky rajon ishte spastëruar menjëherë etnikisht dhe një numër i madh prej shqiptarëve u zhvendosën në Kosovë afër kufirit, duke shpresuar që do të kthehen prapë në tokat e tyre. Numri i refugjatëve ende është i distukueshëm, por mund të supozojmë se më së pakti 50.000 njerëz ishin dëbuar nga vendbanimet e tyre.³

"Marrëdhëniet etnike në territor u përkeqësuan pas dimrit të vitit 1877-78, kur forcat serbe 'pastruan etnikisht' Serbinë jugore, duke krijuar një peizazh të fshatrave të djegura, ndërsa 'në anë të rrugës, në

¹ Bislim B. Pireva, Dhuna njëqindvjeçare Serbe. Magazin Gallapi. Nr. 7, dhjetor 2011, fq. 39. (origjinal nga Tihomir Djordjevic, Srpske novine, Beograd 1838).

² Pireva, Dhuna njëqindvjeçare Serbe, fq. 39. (është bazuar në Nikola P. Ilic: Oslobodjenje juzne Srbije 1877-1878, Beograd 1972, f.15 edhe për numrin e popullsisë shqiptare në rajonin e Prokupljes, Kurshumlisë dhe Nishit të cilët janë dëbuar nga këto treva 1877/78).

³ Noel Malcolm, Kosovo. A Short History. (Londër, 1999), fq. 229-230. Batakoviç jep një numër të ngjashëm, duke thënë: "Nga Toplica dhe Pomoravlje, u tërhoqën rreth 30.000 shqiptarë me ushtrinë turke, duke kërkuar shpëtimin e tyre deri në fushat e Kosovës. <http://www.Bataković.com/Geschichte.html> (vizituar më 07.09.2018).

grykën e Gudelicës dhe deri në Vranjë e Kumanovë, mund të shihni kufomat e braktisura të fëmijëve dhe pleqtë e ngrirë për vdekje.”⁴

Në anën tjetër emigrimi i serbëve, të cilët kishin mundësi të përvetësonin tokat shqiptare prej Nishit deri në Vranje, nuk i ndryshojë dukshëm statistikën në favor të shqiptarëve, siç portretizohen në historiografinë serbe. Edith Durham vuri re, se në Kosovë elementi i Serbisë mezi u gjet, mbase ajo e përshkruan se nuk e priste që elementi serb ishte vetëm një pikë në oqean.⁵

Në vitet 1912-13, gjatë luftërave ballkanike, Kosova bie nën kontrollin e Serbisë dhe iu nënshtua një politike agresive të represionit ashpër në të cilën elementi shqiptar po përpiquej të zhvendosej dhe asgjësohej nga kjo hapësirë. Mbretëria serbe duhej të pajtohej me formimin e një Shqipërie autonome, por hodhi poshtë një demarkim sipas rrethanave etnike. Shpjegimi i mëposhtëm gjendet në një memorandum për Konferencën e Ambasadorëve, 1913: “...Zonat me popullsi të përzier serbo-shqiptare, ku islamizimi i dhunshëm, albanizimi dhe zhvendosja e popullsisë serbe u mbështetën me shekuj, nuk mund të bëhen pjesë e Shqipërisë. Serbia dhe Mali i Zi nuk do të pajtohen kurrë që Kosova me Pejë, Deçan dhe Gjakovë, gjithmonë toka e shenjtë e popullit serb, që do t'i jepeshin dikujt tjetër...”⁶

Gjatë pushtimit të Kosovës, krime të rënda u kryen nga ushtria serbe ndaj popullsisë civile shqiptare, me shifra që shkonin mbi 20.000, siç tregon Leo Freundlich, një gazetar në përcjellje të ushtrisë Serbe, nga zona e luftës.

⁴ Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*. (Londër, 2000), fq. 9.

⁵ Mary Edith Durham, *High Albania*. (Londër, 1909), fq.269.

⁶ Sandra Baiertl, *Möglichkeiten und Probleme einer Autonomieregelung für das Kosovo*. Punim i Diplomës. (Vjenë, 2001), fq. 80.

*“Kronika e përditshme raportoi më 12 nëntor 1912 se ishte e vërtetë se mijëra arnautë (shqiptarë) ishin masakruar nga serbët. 2.000 myslimanë u therën pranë Shkupit dhe 5.000 të tjerë pranë Prizrenit. Shumë fshatrave u është vu zjarri dhe banorët e tyre janë therur. Familjet shqiptare u vranë thjesht gjatë kontrollimit të armëve nga shtëpia në shtëpi, edhe kur nuk u gjetën armë. Serbët deklaruan hapur se shqiptarët myslimanë do të shfarosen, sepse kjo ishte e vetmja mënyrë për të qetësuar vendin.”*⁷

Këto ngjarje kanë mbetur si një traumë në kujtesën e popullatës shqiptare të Kosovës dhe janë transmetuar me respekt të madh ndaj viktimave.⁸ Libri i Leon Trotskit “Luftërat Ballkanike” dhe memorandum i Leo Freundlich për Fuqitë e Mëdha "Golgotha e Shqipërisë" janë ruajtur nga kjo periudhë dhe përshkruajnë rrethanat dhe rrjedhën e luftës nga një distancë e afërt.

Një komitet ndërkombëtar, i cili u dërgua në këtë rajon nga Konferenca e Londrës në vitin 1913, gjithashtu shkroi një raport mbi ngjarjet e luftës. Këta u përpoqën të regjistronjë popullsinë e fshatrave, e cila kish ndryshuar rrënjësisht në disa rajone, pasi në disa raste u gjetën vendbanime tërësisht të zbrazëta.

⁷ Leo Freundlich, Albania's Golgotha. Indictments of the Extermination of the Albanian People. (Vjenë, 1913), fq. 10.

⁸ Nusret Pllana, Der Terror der Besatzungsmacht Serbien gegen die Albaner 1844-1999. (Prishtina, 2011³), fq. 43. Jep numrin e refugjatëve që u detyruan të largohen nga Kosova në baza mujore. Numri i përgjithshëm nga nëntori 1912 deri në korrik 1914 arrin në 292.087 persona të cilët u dëbuan me forcë. Këto shifra janë diskutuar gjerësisht, megjithatë, ata janë vërtetuar nga prova të reja shkencore, pasi në të njejtën periudhë Turqia ka pranuar 239.807 shqiptarë. E vetmja pyetje që mbetet e papërgjigjur është, se ai ishin të gjithë nga Kosova. Mes viteve 1919 dhe 1941, edhe 225.878 persona u dëbuan nga Kosova.

“Shtëpitë dhe fshatrat ishin bërë tërësisht shkrumë e hi, popullsia e paarmatosura dhe e pafajshme është masakruar... të tilla ishin mjetet të cilat ishin përdorur dhe ende janë duke u përdorur nga ushtria serbo-malazeze, me qëllim transformimin e tërësishtëm të karakterit etnik të rajoneve të banuara ekskluzivisht nga shqiptarët.”⁹

Shumë detaje të luftës dhe ngjarjeve u bënë të njohura nga këta dy korrespondentë tek publiku perëndimor. Mbi të gjitha, mizoritë e kryera kundër popullatës shqiptare kanë hyrë thellë në kujtesën kolektive të popullatës shqiptare në Kosovë dhe mbahen ende gjallë. Në anën tjetër, mbrojtja e vendit nga heronjtë shqiptarë përjeton një domethënie pothuajse të shenjtë dhënë kontributit të tyre në emër të drejtësisë.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, filloi qeveria e Mbretërisë së SHS, e cila ishte tërësisht e qeverisur nga Beogradi dhe shumica e vendimeve u morën në favor të serbëve për të serbizuar Kosovën. Kur një delegacion i shqiptarëve të Kosovës tregoj para Lidhjes së Kombeve në Gjenevë në vitin 1921 për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, ankesa e tyre u injorua. Gjithashtu edhe masakrat e kryera nga trupat serbe nuk ishin një çështje me vlerë për t’u diskutuar në Lidhjen e Kombeve. Delegacioni shqiptar akuzoj qeverinë e Beogradit për vrasjen e mbi 12.000 shqiptarëve dhe burgosjen e mbi 22.000 të tjerëve që nga viti 1918.¹⁰

Programi i kolonizimit dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, e detyruan popullin shqiptarë që të organizojë një kryengritje në Kosovë, e cila zgjati deri në vitin 1927 duke marrë fund me vdekjen e dy

⁹ Clark, Civil Resistance, fq. 224.

¹⁰ Malcolm, Kosovo, fq. 278.

udhëheqësve të rëndësishëm Azem Bejt Galica (u vra më 1925) dhe bashkëshortes së tij Shote Galica (e cila vdiq më 1927).¹¹

Noel Malcolm i sheh këto trazirat si një faktor të rëndësishëm që ka punuar kundër kolonizimit të Kosovës, pasi shumë serbë kishin frikë t'u vendoseshin në këtë rajon. Ai vë në dukje se kaçakët, me rezistencën e tyre, kanë arritur dy qëllimet e tyre të rëndësishme. Në vitin 1931, pjesa e popullsisë shqiptare në Kosovë ishte ende rreth 63%.¹²

Megjithëse rreth 70.000¹³ kolonistë u vendosën në Kosovë, rritja e popullsisë sllave mund të regjistrohej vetëm për një kohë të shkurtër. Në disa rajone që nuk kishin asnjë serb para periudhës së kolonizimit, tanishfaqej një numër i vogël i popullsisë serbe. Shqiptarët janë parë si emigrantë dhe për këtë ata duhej detyruar që të kthehen në Turqi ose të asimilohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Popullsia shqiptare e Kosovës iu nënshtrua një represioni të ashpër.

“Shteti i ri kishte nënshkruar një Traktat për Mbrojtjen e Minoriteteve, por - duke mos njohur shqiptarët si një pakicë kombëtare - u mohoi atyre të drejtën për arsimim në gjuhën e tyre. Në vitin 1930, tre priftërinjtë katolikë shqiptarë paraqitën një memorandum në Lidhjen e Kombeve duke shqyrtuar artikull pas artikulli se si po e shkelte Jugosllavia traktatin - politikat e 'emigrimit të detyruar',

¹¹ Clark, Civil Resistance, fq. 28.

¹² Malcom, Kosovo, fq. 282, poashtu shih Dušan Bataković, Kosovo and Metohija. Serbia's Troublesome Province. Im Balnanka XXXIX (2008). Institute for Balkan Studies, (Belgrad, 2009), fq. 248.

¹³ Bataković, Kosovo and Metohija, fq. 248. „The implementation of extensive social and agrarian reforms led to the repopulation of the area by roughly 60.000 Serb colonists.“ Edhe Malcolm, fq. 282, flet për ekzistimin e rreth 13.000 familjeve, me afër 70.000 individë të cilët erdhën në Kosovë.

konfiskimin e pasurisë, zëvendësimin e zyrtarëve komunalë shqiptarë, kufizimet e vishave, si dhe një mori veprimesh kundër arsimit shqiptar."¹⁴

Eksodi i shqiptarëve, i cili u mundua të arrihej nëpërmjet represionit, ishte i kufizuar pavarësisht nga të gjitha rrethanat negative. Në zhgënjimin e dështimit të serbizimit të Kosovës, Vasa Çubrilović (Čubrilović) në vitin 1937, vendosi të shkruajë një memorandum që propozon veprime të mëtejshme mbi zgjidhjen e Kosovës. Ai sugjeroi dëbimin e rreth 40.000 familjeve shqiptare në Turqi për të populluar Kosovën me kolonistë serbë. Në memorandumun e tij ai përshkruan rrjedhën e saktë të planeve të tij për zbatimin e këtyre planeve.¹⁵

Më vonë ai radikalizoi pikëpamjet e tij dhe kërkoi largimin total të shqiptarëve për të zgjidhur problemin. Duke vepruar kështu, ai rekomandon spastrimin etnik në mënyrë sistematike të vendit dhe dëbimin e popullsisë shqiptare të Kosovës drejt Shqipërisë ose Turqisë.

Pas tërheqjes së gjermanëve, ushtria jugosllave burgosi shqiptarë të shquar dhe kreu çarmatim masiv për "ta paqësuar" Kosovën. Territori duhej sjellur nën kontrollin drejtpërdrejt të Beogradit, duke eliminuar të gjitha elementet shqetësuese.¹⁶ Goditja

¹⁴ Clark, Civil Resistance, fq. 10. Shih dokumentin original tek Robert Elsie, Texts and Documents of Albanian History. 1930. Gjon Bisaku, Shtjefën Kurti & Luigj Gashi: The Situation of the Albanian Minority in Yugoslavia Memorandum Presented to the League of Nations. Online http://www.albanianhistory.net/1930_Bisaku-Kurti-Gashi/index.html (vizituar më 08.09.2018). Shih edhe Robert Elsie, Gathering Clouds: the Roots of Ethnic Cleansing in Kosovo and Macedonia. (Peja, 2002), fq. 47-96.

¹⁵ Vasa Cubrilovic, Die Vertreibung der Albaner. Denkschrift, prezantuar më 7 Mars 1937 në Beograd.

¹⁶ Clark, Civil Resistance, fq. 30.

nga Beograd u krye me ashpërsi brutale, duke vrarë 48.000¹⁷ shqiptarë, përfshirë shumë gra dhe fëmijë. Ishte një gjendje që mund të përshkruhej si luftë kundër popullësisë civile. Njerëzit u lidhën në grupe dhe u hodhën në lumë, sepse ata u panë si rrezik nga Beogradi, gjë që iu ndodhi rreth 250 shqiptarëve nga Skenderaj.¹⁸ Por edhe vrasja masive e organizuar ndaj vullnetarëve shqiptarë u bë një realitet i idhur.

*“Ndoshta mizoria më e keqe ka ndodhur në Tivar të Malit të Zi, ku 1.670 shqiptarë u futën në një tunel, i cili u mbyll më pas në mënyrë që të gjithë të asfiksoheshin.”*¹⁹

Pasi kryengritjet në Kosovën qendrore u shtypën dhe qeveria jugosllave kishte sjellë gjithë territorin e Kosovës nën kontroll, tradita e politikës së paraluftës ishte ringjallur. Ministri i Brendshëm Aleksandar Ranković kishte komandën e policisë politike UDBA (Uprava državne bezbednosti) përsipër, e cila ishte përgjegjëse për dhunën shtetërore autoritative kundër popullatës shqiptare.²⁰

Nga viti 1950 deri në pensionimin e Rankovićit në vitin 1966, kanë emigruar sipas statistikave të ndryshme, deri në 200.000 shqiptarë dhe muslimanë nga Jugosllavia në Turqi. Rreth gjysma prej tyre, përafërsisht 100.000 kanë qenë nga Kosova dhe pjesa tjetër nga Maqedonia, Sanxhaki dhe Lugina e Preshevës.²¹ Tentativa për të

¹⁷ Malcolm, Kosovo, fq. 312. Ai flet për mbi 40.000 të vdekur që vdiqën në kryengritjet e Kosovës.

¹⁸ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian. A History of Kosovo*. (Londër, 1998), fq. 142.

¹⁹ Vickers, *Between Serbs and Albanians*, fq. 143.

²⁰ Tim Judah, *Kosovo. War and Revenge*. (Londër, 2002), fq. 53.

²¹ Clark, *Civil Resistance*, fq. 11-12. Judah, *Kosovo*, fq. 52. *“Between 1952 and 1967 around 175.000 Muslims emigrated to Turkey. Many of those would have been Macedonian or Bosnian Muslims or ethnic Turks, but the majority are most likely to have been Albanians.”*

zëvendësuar popullatën e zhvendosur apo emiguar me serb nuk e kishte suksesin e dëshiruar. Ashtu si para luftës, banorët serbë morën mbështetje shtetërore kur u vendosën në Kosovë.

Kushtetuta e vitit 1974 ripërcaktoi qëndrimin e "krahinës autonome" të Kosovës në kuadër të Federatës. Në atë kohë, pati një zhvillim pozitiv, pasi që filloj të mbizontronte elementi shqiptarë edhe në jetën publike dhe institucionale. Por, pakënaqësia tek popullata shqiptare mori një kahe, duke u vetëdijesuar përmes arsimimit të lartë. Kur protestat e studentëve në Prishtinë filluan në vitin 1981²², me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe përmirësimit të mundësive të studimit, ata u përhapen tek minatorët, të cilët më vonë u bashkuan me disa intelektualë. Gjendja e jashtëzakonshme shpallet shpejt mbi Kosovën dhe ushtria duhej të ndërhynte për ta sjellë situatën nën kontroll.

Në atë kohë, përqindja e popullsisë serbe ishte rreth 15%, por ata kishin 30% të vendeve të punës në sektorin publik.²³ Kjo shkaktoi pakënaqësinë e popullsisë shqiptare, pasi që ata donin të shihnin një rishpërndarje të drejtë të posteve. Kur u botua memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, i njohur thjesht si memorandumi SANU në vitin 1986²⁴, që fliste për eksodin e serbëve nga Kosova, gjë që nuk kishte të bëj asgjë me realitetin, sepse serbët u largoheshin nga Kosova, mbase ata e bënë këtë kryesisht për arsye

²² Malcolm, fq. 334, shih edhe Christine von Kohl dhe Wolfgang Libal, Kosovo: Der Gordische Knoten des Balkan. (Vjenë, Cyrih, 1992), fq. 76, edhe Judah, Kosovo, fq. 42, shih edhe Johannes Grotzky, Balkankrieg. (Mynih, 1993), fq. 15.

²³ von Kohl und Libal, fq. 75, dhe Malcolm, fq. 337.

²⁴ von Kohl und Libal, fq. 107, dhe Malcolm, fq. 340, shih edhe Judah, Kosovo, fq. 48, po ashtu Jens Reuter, Konrad Clewing, Der Kosovo Konflikt. Ursachen, Verlauf, Perspektiven.(Ed.). (Klagenfurt: Wieser-Verlag, 2000), fq. 187.

ekonomike, si p.sh. papunësia e lartë, zhvillimi i pamjaftueshëm, mundësitë e pakta arsimore, etj.²⁵ Por ky botim e shihte një zhvillim të tillë lidhur me lëvizjen e popullatës serbe si dëbim të popullatës serbe. Ata kërkojnë një program të ri që do të garantojë një zgjidhje të përhershme të serbëve në Kosovë. Në këtë referendum flitet për eksodin e popullsisë serbe, numri i supozuar i të cilëve shkon deri në 200.000²⁶ dhe se popullsia shqiptare është rritur jashtëzakonisht që nga viti 1945, me ardhje të panumërta nga Shqipëria.²⁷

Me fjalimin e famshëm të Millosheviqit në Kosovës më 28 qershor 1989,²⁸ ditën e Vidovdanit, fillon shtypja e re kundër popullatës shqiptare në Kosovë, e cila kulmoi në luftën e hapur dhe spastrimin etnik të viteve 1998/99. Në vitin 1989 arrestohet Azem Vllasi dhe shpërbëhet greva a urisë së minatorëve të Star Tërgut (Stari Trg) nga policia speciale, ku kanë humbur jetën 32 protestues.²⁹ Pas largimit nga puna të disa qindra mijë punëtorëve të shërbimit publik, popullsia shqiptare në Kosovë ishte e detyruar të emigronte për motive etno-

²⁵ von Kohl und Libal, fq. 74.

²⁶ Konrad Clewnig jep një numër prej rreth 40.000, të cilët kryesisht për shkak të arsyeve ekonomike janë larguar nga vendi, ose për shkak të arsimimit të dobët në përgjithësi. Reuters, Clewing, fq. 58-60.

²⁷ Misha Glenny, *The Balkans 1804-1999. Nationalism, War and the Great Powers* (Londër, 2000), fq. 627.

²⁸ von Kohl und Libal, fq. 121, dhe Malcolm, fq. 344, po ashtu Viktor Meier, *Jugoslawiens Erben* (Mynih, 2001), fq. 83. Judah, *Kosovo*, fq. 56. Slobodan Milosevic's 1989 St. Vitus Day Speech. Artikel më 28.06.1989 online <http://www.slobodan-milosevic.org/spch-kosovo1989.htm> (vizituar më 07.09.2018)

²⁹ von Kohl und Libal, fq. 111.

politike dhe ekonomike, që arriti shifrën marramendëse prej rreth 400.000 që nga mesi i viteve 1990-a deri më 1999.³⁰

Gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-99, popullata civile ishte caku kryesor i sulmeve dhe dhunës sistematike, duke i detyruar me forcë që të largohen nga vendlindja e tyre. Pas sulmeve të NATO-s dhe tërheqjes së detyruar serbe, njerëzit u kthyen në atdheun e tyre, duke u akuzuar nga Beogradi se rreth 200.000 shqiptarë nga Shqipëria kishin ardhur me të zhvendosurit për të ndryshuar strukturën e popullsisë në favor të shqiptarëve.³¹

Zhgënjimi i fundit, ku edhe UNMIK-u dhe KFOR-i luajtën një rol negativ dhe me këtë veprim e humbnin shumë respektin në mesin e popullatës, ishte zhvendosja e 1/3 e banorëve shqiptarë që jetojnë në veri të Mitrovicës drejt pjesës jugore të qytetit në vitin 2000.³²

³⁰ Konrad Clewing, Bevölkerungsentwicklung und Siedlungspolitik: Die ethnische Zusammensetzung des Kosovo. In: Bernhard Chiari und Agilolf Keßelring, Wegweiser zur Geschichte Kosovo. (Paderborn/Mynih/Vjenë/Cyrih, 2008), fq. 22.

³¹ Clewing, Bevölkerungsentwicklung und Siedlungspolitik, fq. 16.

³² International Crisis Group, Bridging Kosovo's Mitrovica Divide. Europe Report Nr. 165 – 13. September 2005, fq. 3-4. Shih Shpend Kursani, A Comprehensive Vision for the North. The Final Countdown. Kosovar Institute for Policy research and development. Policy Paper Series 2012/02. fq. 6. „*The Serb extremists kill 11 Kosovo Albanians in northern Mitrovica, which resulted to an exodus of up to 6.000 Kosovo Albanians from the northern part of the city (3.000 remain today).*” Në internet ka raporte që flasin për numra shumë më të lartë. “*1564 familje shqiptare u dëbuan me dhunë nën sytë e KFOR-it. KFOR-i (trupa franceze) mbështeti "evakuimin" e shqiptarëve nga veriu i Mitrovicës. Sot jetojnë rreth 13.000 serbë në veri të qytetit të Mitrovicës – ndonëse janë 11.000 shqiptarë të zhvendosur nga veriu i qytetit.*” Agron Sadiku, Der Kampf um Mitrovica und die Grenze im Norden. Artikel më 14.08.2011 online http://www.kosova-aktuell.de/index.php?option=com_content&view=article&id=170:der-kampf-um-mitrovica-und-die-grenze-im-norden&catid=2 (vizituar më 15.09.2018).

Të gjitha këto ngjarje janë të rrënjosura thellë në kujtesën e shoqërisë kosovare. Për më tepër, interpretimi i ngjarjeve nga pseudo-historianë dhe gazetarë është subjekt i politizimit të fortë. Mistifikim i viktimitave të familjes Jashari është kurorëzimi i 150 vitevetë fundit, në të cilën shumë civilë u zhdukën dhe kanë ra viktimë në konfliktin me Serbinë. Kjo është shumë e rëndësishme sepse ato shihen si viktimat e fundit të pavarësisë së Kosovës dhe duhet të kujtohen si përmbyllja e vuajtjes shekullore të popullit.

Tradita mbi tregimin e heroizimit dhe martirizimit

Rezistenca ndaj represionit të huaj tradicionalisht është thellësisht e rrënjosur në historitë dhe kujtimet e popullatës shqiptare.³³ Kjo fillon me Skënderbeun, i cili udhëhoqi një rezistencë kundër osmanëve mes 1443 dhe 1468, deri në kurorëzimin e tij përfundimtar me martirizimin e Adem Jasharit dhe familjes së tij në mars të vitit 1998.

“Jashari është i fundit i një brezi të gjatë të patriotëve.”³⁴

³³ Anna Di Lellio and Stephanie Schwandner-Sievers, The Legendary Commander: the construction of an Albanian master-narrative in post-war Kosovo. *Journal of Nations and Nationalism* 12(3)/2006, fq. 514.

³⁴ Anna Di Lellio, *The Field of the Blackbirds and the Battle for Europe*. The New School, New York and Kosovo Institute of Journalism and Communication, Prishtina. *International Affairs Working Paper* 2011-08. September 2011. fq. 10. (Forthcoming chapter in Bill Niven, Ruth Wittlinger and Eric Langenbacher, editors. *Dynamics of Memory in the New Europe*, Bergham Books 2011).

“Jashari është Skënderbeu i ri, ikona e vërtetë kombëtare për shqiptarët e Kosovës. Imazhi i tij është i gjithëpranishëm; ai mishëron luftën dhe rezistencën e vazhdueshme të shqiptarëve.”³⁵

Me kalimin e kohës, gjithnjë e më shumë dëshmorë dhe heronj janë shtuar në listën e luftëtarëve të rezistencës kundër okupatorëve. Pas aneksimit të Kosovës nga Serbia në vitin 1912, lufta e rezistencës u bë simbol i popullatës shqiptare të Kosovës.³⁶ Personalitete si Isa Boletini, Bajram Curri, Azem Bejt Galica, Shote Galica, Hasan Prishtina dhe shumë të tjerë, janë përfaqësuesit e parë të rëndësishëm të një tradite të gjatë të rezistencës ndaj represionit serb në Kosovë. Vdekja e tyre dhe aktivitetet e tyre heroike këndohen në këngë dhe mbahen në kujtesë me poezi. Respekti për këto personalitete është i gjerë dhe është ruajtur deri në ditët e sotme, në mënyrë që nipat e mbesat të gëzojnë reputacion të madh në shoqërinë shqiptare, jo vetëm në Kosovë, por edhe në diasporë.

Individualizimi i heroit nga “folklori” është tradita kulturore (politike) e shqiptarëve të veriut dhe të Kosovës e cila është përhapur kryesisht në rajonin rural.

“Sugjerimet tradicionale rurale janë të ndërjegjshme në tregimin kryesor, të tilla që legjenda të tregohet dhe riprodhohet në stilin lokal të këngëve popullore epike. Ata festojnë vendin, Drenicën, “malet” dhe pajisjet tipike të heronjve të luftëtarëve shqiptarë: armët, herë pas here çiftelinë (një mandolinë me dy vargje instrumentesh), kullën (shtëpi mbrojtëse) dhe odën (dhoma e rezervuar për mbledhjen

³⁵ Vedran Obućina, A War of Myths. Creation of the Founding Myth of Kosovo Albanians. CONTEMPORARY issues, (2011) Vol. 4, No. 1. fq. 37. Di Lelliomendon se, „he never played or will play the same role as GjergjKastrioti, also known as Skanderbeg.” Di Lellio, The Field of the Blackbirds, fq. 10.

³⁶ Di Lellio and Sievers, The Legendary Commander, fq. 514.

*e burrave), ku pleqtë zakonisht recitojnë epikat heroike të rebelëve patriotikë shqiptarë.*³⁷

Ky lloj i ndërmjetësimit ishte shumë i zakonshëm dhe epika “*Lahuta e Malcis*” ishte veçanërisht popullore. Ajo përbëhet nga 15.613 rreshta, dhe përshkruan në mënyrë kronologjike historinë e Shqipërisë, të cilën e përshkruan si një luftë të gjatë për paqe. Nga kjo epikë u citua shumë shpesh në oda. Meqenëse shoqëria shqiptare në Kosovë, nuk ishte e lejuar të kishte libra në gjuhën shqipe deri në vitet 1950-a dhe nga ana tjetër kishte një shkallë të lartë të analfabetizmit, sidomos në zonat rurale, njerëzit u detyruan të mbanin në mend recitimin e poezive në mënyrë që ata në oda mund të recitoheshin. Prandaj, oda shihet si një faktor i rëndësishëm social për shoqërinë shqiptare në Kosovë.

“Në zonat rurale në mbarë Kosovën, oda ishte dhe ende është hapësira kryesore e mbledhjes shoqërore mes njerëzve, ku arti i tregimit mbahet gjallë. Për një biznesmen të moshuar të lindur në Drenicë, dhe që emigroi në Nju Jork (New York) në vitet 1960, ishte 'një shkollë jete'. “Gjithçka që kam dëgjuar në odë është ende e gdhendur në kokën time”, tha një ish-komandant i UÇK-së i cili vinte nga një fshat në komunën jugore të Gjilanit - “Mbaj mend akoma herën e parë që hyra në odë, isha 13 vjeç, ata po këndonin këngën e Fazli Graiçefçit dhe madje vetëm duke folur për këtë tani më rrënoqethë. “Një djalë tetëmbëdhjetë vjeçar nga fshati lindor i Therandës shpjegoi: ‘Kur nuk kishim shkollë dhe ku të shkonim, qëndruam në oda, ku mësuam për vendin tonë, popullin tonë dhe traditën; dhe ne dëgjuam këngë, dhe nejtëm me miqtë.’”³⁸

³⁷ Po aty, fq. 519.

³⁸ Po aty, fq. 519.

Tregimet nëpër oda bazohen në konceptin e besimit të fortë në fjalën e dhënë (besa) dhe besnikërinë e cila është e rrënjosur thellë në traditë, si dhe në “Kanunin e Lekë Dukagjinit”. Besa krijon një përgjegjësi dhe marrëdhënie midis familjeve dhe gjithashtu detyrime ndaj mikut që kërkon solidaritet të pakufizuar, besnikëri dhe përgjegjësi për të qenë besnik, si dhe fshehtësi ndaj të huajve.³⁹

Edhe Lëvizja Kaçake e periudhës mes dy luftërave, e cila zgjati deri në vitet 1940, shihet si një lëvizje e pavarësisë dhe konsiderohet simbol i asaj kohe.

*“Është e qartë se, në përgjithësi, Lëvizja Kaçake ishte një fenomen politik, i drejtuar kundër sundimit serb, dhe është e qartë se politikant antishqiptare të qeverisë dhe autoriteteve lokale (përfshirë të gjithë programin e kolonizimit) ishin një stimul i fuqishëm për rebelim.”*⁴⁰

UÇK-ja mund të shihet si pasardhëse e kësaj Lëvizjeje Kaçake, pasi popullata shqiptare në Kosovë deri në vitet 1990, jo më me forcë armësh, por në mënyrë paqësore u përpoq t’i arrij qëllimet e saja. Meqë shtypja dhe presioni nga Beogradi u bë i padurueshëm, kjo dukej se ishte e vetmja mënyrë për t’i dhënë Kosovës të drejtat që meritonte. Ngjarjet e viteve 1990 krijuan një ndërgjegjësim dhe mirëkuptim të ri të një kombi midis shqiptarëve, të formuar nga faktorë të ndryshëm.

“Në vitet 1990-a, një identitet kombëtar shqiptar, i cili paraqet pretendime unike për Kosovën e atëhershme jugosllave, u homogjenizua nga poshtë, por edhe nga sipër: nga poshtë përmes rezistencës popullore në formë të mosbindjes civile dhe krijimit të shoqërisë shqiptare paralel ndaj shtetit serb, ndërsa qelizat

³⁹ Di Lellio and Sievers, *The Legendary Commander*, fq. 519.

⁴⁰ Malcolm, *Kosovo*, fq. 273.

nëntokësore filluan të planifikonin një luftë guerile; nga lart, për shkak të represionit të drejtpërdrejtë të shtetit, si dhe politikës që përcakton grupet etnike dhe cakton të drejtat. E drejta kushtetuese për autonomi ndaj Jugosllavisë dhe identifikimi me një “traditë shqiptare të durimit dhe maturisë që e kundërshton sundimin”, shënoi këtë identitet kombëtar.”⁴¹

Për të kujtuar luftën e fundit dhe vuajtjen shekullore, u krijua kulti i varrezave heroike dhe vendeve përkujtimore i cili ka arritur një shkallë tejet të lartë në Kosovë. Gjithkush dëshiron që fëmijët e tyre, të cilët luftuan për paqe dhe vdiqën, të kujtohen në këtë mënyrë dhe të krijohet një kulturë e përkujtimit në Kosovë dhe të fitojnë pranimin e gjerë të publikut.⁴²

Përveç këtyre personave të përmendur përfshihen më shumë se 150 heronj të tjerë kombëtarë të cilët kujtohen në forma të ndryshme. Martirizimi i familjes Jashari, e cila nuk shihet vetëm si heroike, por si një simbol i të gjitha viktimave të represionit të Beogradit, është një pjesë e rëndësishme e identitetit kombëtar.

Rrëfimi mbi qëndresën e familjes Jashari

Ngjarjet që e krijuan rrëfimin mbi qëndresën e familjes Jashari filluan në Prekaz në mars 1998 dhe zgjatën tri ditë (5.3-7.3),⁴³ kur

⁴¹ Di Lellio and Sievers, *The Legendary Commander*, fq. 515.

⁴² Stephanie Schwandner-Sievers, *Stolz und Schmerz: Albanische Sinnstiftung durch Erinnerung an Krieg und Sozialismus im Kosovo vor dem endgültigen Status*. In: Ulf Brunnbauer, Andreas Heimedach, Stefan Troebst (Hrsg.), *Schnittstellen: Gesellschaft, Nation, Konflikt und Erinnerung in Südosteuropa: Festschrift für Holm Sundhaussen zum 65. Geburtstag*. (Oldenburg, 2007), fq. 565.

⁴³ Di Lellio und Sievers, *The Legendary Commander*, fq. 515.

Adem Jashari dhe 50 persona tjerë, kryesisht femra dhe fëmijë u vranë nga forcat policore serbe, duke përfshirë 25 anëtarë të familjes Jashari.⁴⁴ Kjo e bëri Adem Jasharin, i cili konsiderohet themelues dhe komandant i UÇK-së dhe familjen së tij, një hero popullor i gjithë shqiptarëve të Kosovës.

“Më 5 mars një vendosje e madhe e forcave të përziera serbe, përfshirë policinë dhe forcat speciale të armatosura me artileri të rëndë, mbyllën zonën përreth kompleksit të Jasharajve dhe sulmuan. Tre ditë më vonë sulmi përfundoi, me një të vdekur dhe disa të plagosur midis policisë dhe pesdhjetënjë të vdekur në mesin e familjes së zgjeruar Jashari. Njëzet trupa - disa të zhdukur dhe të pidentifikuar - ishin gjithçka që mbeti nga familja e ngushtë. Besarta, vajza njëmbëdhjetë vjeçare e vëllait të Adem Jasharit, Hamzes, ishte e vetmja që kishte mbijetuar.”⁴⁵

Menjëherë pas ngjarjeve të marsit 1998, Adem Jashari u promovua si "Komandanti Legjendar" i UÇK-së, ku shumë shqiptarë të rinj nga mbarë bota u thirrën dhe u bashkuan si vullnetarëve në luftën për pavarësi.⁴⁶

Zhvillimi i jashtëzakonshëm është unik për këtë ngjarje, pasi kishte pas edhe më parë masakra kundër popullsisë civile dhe madje edhe më vonë u kryen masakra ndaj civilëve, por Prekazi mori një pozitë të veçantë, pasi që ata e kishin mbrojtur veten dhe nuk kishin ra

⁴⁴ Zulfija Jakupi, Gedenken an Kosovo-Volkshelden Adem Jashari. Artikel më 10.03.2005 online <http://www.dw-world.de/dw/article/0,,1514790,00.html> (vizituar më 11.09.2018)

⁴⁵ Di Lellio und Sievers, The Legendary Commander, fq. 516. Obućina, A War of Myths, fq. 37.

⁴⁶ Di Lellio und Sievers, The Legendary Commander, S 518.

viktim e një masakrës së zakonshme.⁴⁷ Prandaj, kjo mbahet mend nga popullata shqiptare në Kosovë, si një rezistencë familjare kundër një pushtetit të dhunshëm.

“Protagonistët u vranë, por nuk shfaqen si të mposhtur; ata nuk konsiderohen viktima, por si heronj që nuk njihnin dorëzimin. Ata në fakt quhen Dëshmorët e Kombit, i cili është i njëjtë me Shehidin, megjithëse Jasharajt, ashtu si shumica dërrmuese e shqiptarëve në Kosovë janë myslimanë. Ata janë martirë në kuptimin origjinal të “dëshmisë për kauzën” si të pranishme në teologjitë e krishtera dhe islame: megjithëse u mohohet kombësia, ata dëshmojnë me martirizimin e tyre se kombi ekziston.”⁴⁸

Thashethemet e mbijetesës së tij të mrekullueshme shpejt marrin dhenë. Admiri i heroit daton qysh nga periudhat e lashta, siç është rasti me Herkulin, Akilin etj., dhe të njëjtën e gjejmë edhe tek shqiptarët, siç është rasti edhe me Azem Galicën, për të cilin edhe pas vdekjes së tij konsiderohej se ishte i gjallç dhe vazhdonte luftën nëpër malet përreth. Pra edhe Adem Jashari duhej gjithashtu të përfshihej në rangun e heronjve të pavdekshëm, duke e marrë epitetin e komandantit legjendar.

“Kur agjencitë e lajmeve raportuan se edhe ai ishte vranë në Prekaz, Selimi mendoj se mund të shfrytëzonte konfuzionin: “Duke menduar se kisha vdekur, familja ime ishte kaq e dëshpëruar. . . . i thanë një shoku që të vinte dhe të shihte me sytë e tij. . . E sigurova atë dhe thashë se Ademi ishte aq i gjallë sa isha unë, vetëm duke u fshehur në male.”⁴⁹

⁴⁷ Po aty, fq. 518.

⁴⁸ Tim Judah, What everyone needs to know. (Oxford, 2008), fq. 28.

⁴⁹ Di Lellio und Sievers, The Legendary Commander, fq. 528.

Mbesa që mbijetoi, Besarta, përshkroi ngjarjet e marsit, gjatë së cilës Jasharajt luftuan kundër një armiku superior dhe nuk u lëkundën. Ky narrativ e përhapën gazetarë dhe mësues të fshatit si një stuhi dhe kështu motoja e vjetër “ja vdekja ja liria”, u rikthye në kujtesën e popullit, e cila qëndron për luftën deri në vdekjen dhe sakrificën për dashurinë e vendit.⁵⁰

Këto ngjarje të marsit 1998 shihen si një pikë kthese në historinë e Kosovës që sollën lirinë dhe pavarësinë e vendit. Partitë politike pas luftës duhej të përkulen ndaj presionit publik dhe të paguajnë respektin e tyre ndaj familjes Jashari. Kjo ndodh me një vizitë vjetore në Prekaz që transmetohet drejtpërdrejt nga Radio Televizioni i Kosovës, pasi kjo është bërë qendra përkujtimore e luftës ku është varrosur familja Jashari.⁵¹

“Asnjë nga grupet politike shqiptare aktualisht nuk mund të lejojë që të mos bashkohe me mitin Jashari në rituale politike ose në fjalime. Edhe LDK e Rugovës pretendon që nga lufta, në retrospektivë, se Rugova dhe Jashari punuan së bashku politikisht, edhe pse marrëdhënia e tyre ishte në fakt shumë problematike.”⁵²

Edhe vetë Rugova nuk ishte, deri në vdekjen e tij në janar 2006, kundër mistifikimit të Jasharëve. Në nëntor 2004 Adem Jashari nderohet pas vdekjes nga Rugova me medaljen e artë “Hero i Kosovës”. Pas vdekjes së tij, një luftë kujtimi u zhvillua mbi kultin Jashari, i cili kishte të bënte me dominimin politik, pasi secila parti

⁵⁰ Po aty, fq. 516.

⁵¹ Obućina, A War of Myths, fq. 39.

⁵² Sievers, Stolz und Schmerz, fq. 567.

dëshironte të identifikohej me mitin e “heroit të luftës”.⁵³

U krijua një institucion memorial për familjen Jashari dhe çdo politikan, shkollë dhe popullsia shqiptare krijuan një traditë të pelegrinazhit modern drejt Prekazit, për të nderuar kontributin e familjes Jashari.

*“Botimet historiografike dhe literatura komerciale që dalin nga vendi i ri i pelegrinazhit e kremtojnë heroin e ri kombëtar si ‘Komandant Legjendar’ si pasardhës historik të Skënderbeut.”*⁵⁴

Udhërrëfyesit tërheqin gjithashtu vëmendjen për kultin e familjes Jashari, e cili ka pothuajse një status ritual dhe konsiderohet si vendi më i rëndësishëm për krijimin e një identiteti të ri në Kosovë. Kështu që nipi i Adem Jasharit, Murat Jashari, jep një pamje të qartë dhe të kthjellët se si është duke u parë familja e tij në Kosovë.

*“Çdo komb ka një shenjtor dhe një histori që është themeli që formon shoqërinë, bazën e saj. Historia e familjes sime është lidhja e një zinxhiri, një lëvizje historike. Historia është një zinxhir që i takon shqiptarëve, Azem Galicës, Shaban Palluzhës dhe të tjerëve. Shqiptarët kanë qenë gjithmonë nën një pushtet shtypës të huaj, qoftë Turqia, Austria, Serbia, dhe ka pasur shumë momente të luftës për liri: kjo është çështja kombëtare shqiptare në Ballkan.”*⁵⁵

Edhe nëse nuk diskutohet publikisht për këtë kult në Kosovë, ka edhe të tillë që nuk e pranojnë flijimin e familjes Jashari, ashtu siç e pranon dhe e ruan në kujtesë një pjesë dërmuese e popullsisë shqiptare të Kosovës. Nëpër biseda private ka pozicionime që flasin kundër këtij

⁵³ Stephanie Schwandner-Sievers, *Invisible-Inaudible: Albanian Memories of Socialism after the War in Kosovo*. In: Maria Todorova and Zsuzsa Gille (eds), *Post-Communist Nostalgia*. (New York/Berghahn, 2010), fq. 99. 96-112.

⁵⁴ Sievers, Stolz und Schmerz, fq. 567.

⁵⁵ Di Lellio und Sievers, *The Legendary Commander*, fq. 517.

admirimi pothuajse “të shenjtë” të Adem Jasharit, të cilat vijnë kryesisht nga mjedisi urban.⁵⁶ Meqenëse një pozicionim publik kundër “mitit” Jashari në Kosovë nuk është i mundur për arsye të rëndësishë që e ka fituar për identitetin e shqiptarëve në Kosovë, dhe për këtë diskutohet vetëm në qarqe të ngushta, në mënyrë që të minimizohet përhapja e tyre. Kështu, “miti” çon në pozicionime të ndryshme të shoqërisë, gjë që nuk ka sjellë ndonjë diskutim publik,⁵⁷ por tentativa është që të krijohet një sensibilizim kundër këtij “miti” nga disa rryma “urbane” brenda shoqërisë kosovare, e që një gjë e tillë të bënë të mendosh se kjo bie në kundërshtim me identitetin e ri të Kosovës.

Kritika është drejtuar kryesisht kundër krijimit të memorialit të UÇK-së, por krijimi i një kopjeje të Përkujtimit të Veteranëve të Vietnamit në Uashington, jashtë Skenderajt, u mirëprit nga këta kritikues. Prandaj, ka shumë polemika që nga njëra anë duket se shohin një kulturë socialiste të kujtesës dhe nga ana tjetër nuk duan të dalin shumë në pah duke bërë kësi krahasime.⁵⁸

“Ndërsa tregimi kryesor pohon se Jashari ka bashkuar popullin shqiptar dhe i’a dha atij misionin e ndërtimit të një kombi. Në librat e vizitorëve në Prekaz ku shumë vizitorë e pranojnë shprehimisht praninë e Adem Jasharit, zotimin e tij për ‘pavarësi’ dhe ‘liri’ si një trashëgimi, përmbushja e së cilës u është besuar të gjallëve.”⁵⁹

Me fjalët “Bac u kry” figura e tij u shpërnda në të gjithë Kosovën në bluza dhe postera për të përmbushur dëshirën dhe vullnetin e tij të fundit. Një skulpturë e madhe me shkrim “New Born” u zbulua, më 17

⁵⁶ Sievers, *Invisible-Inaudible*, fq. 99.

⁵⁷ Di Lellio und Sievers, *The Legendary Commander*, fq. 520.

⁵⁸ Po aty, fq. 521.

⁵⁹ Po aty, fq. 520.

shkurt 2008, për të simbolizuar një fillim të ri.⁶⁰

Legjenda e familjes Jashari mund të shihet si një shembull se si të krijohet një diskurs kombëtar që rrjedh nga një strukturë shoqërore patriarkale, ku zgjerohet borxhi ndërgjeneratash i familjes në një angazhim kombëtar.⁶¹

Megjithatë, nëse marim për bazë zhvillimet e fundit në Prishtinë, shohim se figura e Adem Jasharit, nuk është se e përfaqëson epitelin e një “Heroi Legjendar”. Sidomos, kur dihet se Adem Jashari e kishte luftuar sistemin komunist dhe për të njëjtin u nda një vend për themelimin e sheshit të quajtur “Adem Jashari”, e që edhe në ditët e sotme në mesin e sheshit “Adem Jashari” gjejmë “Spomenikin - Statujën” e cila simbolizon të ashtuquajturin “Bratstva i Jedinstva - Vllaznim Bashkim” të kohës së komunizmit që nga viti 1961, duke arsyetuar edhe nga “Docomomo International” se një statue e tillë duhet të ruhet, sepse është pjesë e historisë së qytetit dhe trashëgimisë arkitekturore. Edhe nga ana tjetër shihet se ka ende mendime të ndryshme tek qytetarët mbi largimin e monumentit “Vllaznim Bashkimit”

Njëherit përkundër faktit se presidenti i parë i Republikës së Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, e dekoroi Adem Jasharin me udhërin “Heroi i Kosovës”, një pjesë e shoqërisë, përkrahëse e idologjisë politike të njërës ndër organizimet politike më të vjetra në Kosovë, siç është LDK-ja, Adem Jasharin dhe UÇK-në i konsiderojnë si uzurpatorë të idesë së organizimit ushtarakë paralel të UÇK-së të njohur si FARK, dhe si rezultat i kësaj, të tillët nuk e dëshmojnë njohjen e Legjendarizmit të Adem Jasharit.

⁶⁰ Sievers, *Invisible-Inaudible*, fq. 101.

⁶¹ Di Lellio und Sievers, *The Legendary Commander*, fq. 520.

Këta shembujt e lartpërmendura, na bejnë të kuptojmë se shoqëria kosovare nuk është e unifikuar si mendim në çështjen e mitit dhe legjendës së Adem Jasharit, familjes së tij dhe vetë Luftës së fundit të Kosovës.

